

**RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 05/2020**

20 tetor 2020

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ të AAC-së Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren, si në vijim:

Rregullore (AAC) nr. Xx/2020 për aftësimin profesional për punonjësit të cilët kryejnë detyra që ndikojnë në sigurinë e operimeve në aerodrome dhe certifikimin e organizatave për aftësimet profesionale

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, paragrafi 5.2 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, nga data 29 shtator deri më 14 tetor 2020.

Neni 5, paragrafi 5.1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që: “AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuara”

Konsultimi publik për rregulloren në fjalë u realizua sipas paragrafit 5.1a) të Udhëzimit të lartcekur.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes për konsultim publik të palëve të interesit nuk i është përgjigjur askush nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së me sugjerime apo vërejtje.

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me këtë projekt-rregulloren, nuk është parashtruar asnjë vërejtje/komente dhe si rrjedhojë nuk ka pasur nevojë për komentim shtesë nga ana e AAC-së.

Raporti është hartuar nga:

Zyra për çështje ligjore të Aviacionit

Autoriteti i Aviacionit Civil